



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË**

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-222970 • E-mail: filologjia@uni-pr.edu • www.filologjia.uni-pr.edu

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë

Nr. Prot.: 01/ 2357 Data: 14.7.2026

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 14.7.2026, shqyrtoi raportin e komisionit të ankesave ne Nr. Prot.: 03/2264 dt.08.07.2026, sipas nenit 8 të Rregullores me Nr.Prot.: 2/254, dt. 17/7/2024 lidhur me pozitën III.3 të Fakultetit të Filologjisë, mori:

VENDIM

- I. **REFUZOHET SI E PA BAZUAR** ankesa e znj. Teuta Berisha (më poshtë parashtruese e ankesës) e datës 26.6.2026 e parashtruar brenda afatit ligjor sipas njoftimit zyrtar me rastin e publikimit të raportit të komisionit vlerësues me Nr.Prot.: 03/2068, dt. 22/6/2026, parashtruesja e ankesës është candidate e paraqitur në Thirrjen publike 1/746, dt. 29.5.2026 për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime, respektivisht pozitën III.3 për lëndët: Zhanret e gazetarisë I, Media dhe politika, Sistemi politik i BE-së, Zhanret e gazetarisë II, Intervista&Talk Shou, Sistemi politik i BE-së.
- II. **VËRTETOHET** raporti i komisionit vlerësues lidhur vlerësimin për pozitën III.3 të thirrjes së lartpërmendur me Nr.Prot.: 03/2068, dt. 22/6/2026.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë, në mbledhjen jashtëzakonshme me datë 14.7.2026, ka shqyrtuar raportin e Komisionit të Ankesave me Nr. Prot.: 03/2270 dt. 8.7.2026. Ky raport trajton ankesën e znj. Teuta Berisha lidhur me raportin e Komisionit Vlerësues për rivlerësimin e pozitës III.3 të thirrjes me Thirrjen publike 1/746, dt. 29.5.2026 për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime, Komisioni i Ankesave ka konstatuar se, duke marrë parasysh dispozitat e Rregullores me Nr. Prot.: 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni Vlerësues ka evidentuar në raport:

- Notat mesatare në studimet themelore dhe postdiplomike të parashtrueses së ankesës,
- Angazhimin e saj në institucionet e arsimit të lartë,

Gjithashtu, Komisioni i Ankesave, duke u bazuar në raportin e Komisionit Vlerësues me Nr. Prot.: Nr.Prot.: 03/2068, dt. 22/6/2026, dhe dosjet e kandidateve, ka evidentuar se të dyja kandidatet plotësojnë kriteret për angazhim, sipas dispozitave të Rregullores me Nr. Prot.: 2/254, datë 17.07.2024, konkretisht neni 7, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2.

Lidhur me këtë çështje, vendimi është marrë bazuar në diskrecionin që e njëjta Rregullore, në paragrafin 4 të nenit 7, ia njeh Komisionit Vlerësues, ku theksohet: *“Në rastin kur më shumë se një kandidat për pozitën përkatëse i plotëson kriteret e paragrafit 2, përkatësisht 3 të këtij neni, mbetet në diskrecion të Komisionit Vlerësues dhënia e përparësisë kandidatit të caktuar.”*

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë vlerëson se Rregullorja ia njeh të drejtën Komisionit Vlerësues që, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për angazhim, t’i vlerësojë sipas diskrecionit, siç përcaktohet në paragrafin 4 të nenit 7 të Rregullores me Nr. Prot.: 2/254, datë 17.07.2024.

Bazuar në këtë, Këshilli i Fakultetit të Filologjisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 14.7.2026, ka shqyrtuar raportin e Komisionit të Ankesave dhe konkludon se, gjatë vlerësimit, janë marrë për bazë dhe janë respektuar në tërësi dispozitat e Rregullores me Nr. Prot.: 2/254, datë 17.07.2024, të cilat përcaktojnë kushtet dhe kriteret për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Komisioni Vlerësues ka vepruar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 7, duke zbatuar diskrecionin që i është dhënë.

Bashkëngjitur vendimit është raporti i komisionit të ankesave me Nr.Prot.: 03/2270, dt. 08/7/2026.

Duke u bazuar në këtë u vendos si në dispozitiv të vendimit.


Këshillë juridike: *Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të iniciojë kontest në gjykatën kompetente, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit.*

Vendimi t’u dërgohet:

- Arkivit të Fakultetit të Filologjisë,
- Dekanatit të Fakultetit të Filologjisë,
- Sekretarit të Fakultetit të Filologjisë,
- Parashtrues së ankesës znj. Teuta Berisha.

DEKAN

Prof.asoc.dr. Abdulla Rexhepi





UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-222970 • E-mail: filologjia@uni-pr.edu • www.filologjia.uni-pr.edu

Nr. prot: 03/2270
Datë: 01/7/2026

KOMISIONI I ANKESAVE PËR PROFESOR DHE ASISTENT TË ANGAZHUAR I
FAKULTETIT TË FILOLOGJISË
nxjerr këtë:

RAPORT

Kandidati: Teuta Berisha
Ankesa: Nr. prot. 04/2124, datë 29.6.2026
Pozita: Asistent i angazhuar, pika III.3 sipas konkursit të datës 29.5.2026

Komisioni për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për thirrjet profesor dhe asistent i angazhuar, i emëruar sipas vendimit të Dekanit të Fakultetit të Filologjisë, nr. prot. 01/2072, datë 22.6.2026, në përputhje me *Statutin* e UP-së dhe *Rregulloren për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorve të jashtëm në UP*, nr. prot. 2/254, datë 17.7.2024, e ka shqyrtuar ankesën e kandidates Teuta Berisha me nr. prot. 04/2124, datë 29.6.2026, kundër raportit të Komisionit vlerësues, me nr. prot. 03/2068, datë 22.6.2026 për angazhim në asistent i angazhuar, pika III, pozita 3, sipas konkursit me 29.5.2026.

Pas analizimit të dokumentacionit përkatës (raportet vlerësuese dhe dosjet elektronike të kandidatëve), përkitazi me pretendimet e kandidates Berisha, Komisioni i ankesave sjell këto gjetje dhe konstatime:

Pretendimi se arsyetimi i Komisionit Vlerësues është i përgjithshëm dhe se nuk janë marrë në konsideratë rezultatet akademike, përvoja profesionale dhe publikimet e ankueses nuk qëndron, raporti nr. prot. 03/2068, datë 22.6.2026 i Komisionit Vlerësues ka paraqitur në mënyrë të qartë të dhënat për secilin kandidat, përfshirë notën mesatare të studimeve, përvojën në mësimdhënie fakti që parashtuesja e ankesës nuk është propozuar për angazhim nuk nënkupton se këto rrethana nuk janë shqyrtuar apo vlerësuar nga komisioni përkatës.

Sa i përket pretendimit se parashtuesja e ankesë ka notë mesatare më të lartë, përvojë profesionale në fushën e komunikimit politik dhe publikime profesionale që, sipas saj, duhet t'i jepnin përparësi ndaj kandidates së propozuar, Komisioni i Ankesave vlerëson se këto rrethana, ndonëse janë pjesë e dokumentacionit të konkursit dhe janë marrë në konsideratë nga Komisioni Vlerësues, nuk krijojnë të drejtë automatike për përzgjedhje dhe komisioni vlerësues me rastin e propozimit të kandidates ka vepruar në përputhje me paragrafin 3 të nenit 7 të Rregullores nr. Prot. 2/254.

Me rastin e përzgjedhjes së kandidatës, Komisioni Vlerësues ka vepruar në përputhje me dispozitat e Rregullores nr. Prot. 2/254 për procedurat përzgjedhëse për emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik në Universitetin e Prishtinës, konkretisht nenin 7, paragrafi 4 që thekson si në vijim: *“kur më shumë se një kandidat i plotëson kushtet dhe kriteret për angazhim sipas paragrafit 3 të këtij neni lidhur me angazhimin e asistentëve për mbajtjen e ushtrimeve, mbetet në diskrecion të Komisionit Vlerësues t'i japë përparësi njërit prej kandidatëve”,* rrjedhimisht, në situata kur disa kandidatë plotësojnë kushtet formale të konkursit dhe rregullores, Komisioni Vlerësues gëzon të drejtën e vlerësimit profesional për të propozuar kandidatin që e konsideron më të përshtatshëm, për atë kohë sa ky vlerësim është bërë brenda kufijve të parapara në dispozita të rregullores.

Ndërlidhur me interpretimin e dispozitave të Statutit të Universitetit të Prishtinës për përvojën profesionale nuk ndryshojnë këtë përfundim, pasi dispozitat statutores nuk e kufizojnë diskrecionin që rregullorja ia njeh Komisionit Vlerësues në rastet kur disa kandidatë i plotësojnë kushtet për angazhim.

Përfundim

Komisioni i ankesave konstaton se Komisioni vlerësues me rastin e vendimarrjes ka vepruar në përputhje me kërkesat e konkursit dhe dispozitat e rregullores, prandaj bazuar në dispozitat e nr. Prot. 2/254 për procedurat përzgjedhëse për emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik në Universitetin e Prishtinës, i rekomandojmë Këshillit të Fakultetit që të miratohet propozimi i komisionit vlerësues dhe ankesa e parashtruar të konsiderohet e pabazuar.

Prishtinë, më 8.7.2026

Komisioni i ankesave:

Prof. asoc. Muhamed Çitaku (kryetar)

Prof. asoc. Zeqije Xhafçe (anëtare)

Prof. asst. Ardita Berisha (anëtare)

